

**REKOMANDIME PËR
PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE
PERSONALE NGA PARTITË
POLITIKE GJATË
ZGJEDHJEVE LOKALE**



**Agjencia për Mbrojtjen e të
Dhënave Personale**



REKOMANDIME PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA PARTITË POLITIKE GJATË ZGJEDHJEVE LOKALE

Partitë politike kanë një rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor, por edhe një përgjegjësi të madhe për të siguruar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve me të cilat disponojnë dhe i përdorin gjatë zgjedhjeve lokale. Në këtë kontekst, në prag të zgjedhjeve të ardhshme lokale, me qëllim të sigurimit të përpunimit ligjor, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale nga partitë politike gjatë zgjedhjeve lokale, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me detyrat dhe autorizimet e saj të dhëna me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, jep rekomandimet në vijim:



1. LIGJSHMËRIA E PËRPUNIMIT DHE CILËSIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Partitë politike mund të përpunojnë të dhëna personale vetëm nëse ekziston një bazë e qartë ligjore (detyrim ligjor, interes publik ose një bazë tjetër e përshtatshme) ose pëlqimi nga qytetari.

Partitë politike janë të obliguara të kujdesen që të dhënat personale që i përpunojnë të jenë të sakta dhe të përditësuara, si dhe të jenë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara për qëllimet për të cilat mbledhen dhe përpunohen.



2. PËLQIMI NGA QYTETARËT

Gjatë mbledhjes së të dhënave personale (mbështetje, të dhëna kontakti) duhet të merret pëlqim i lirë, specifik, i informuar dhe i qartë nga qytetari. Para dhënies së pëlqimit, qytetarët duhet të informohen qartë se kush i përpunon të dhënat e tyre personale, për cilat qëllime, sa kohë do të ruhen dhe a do të ndahen me palë të treta.

Kur përpunimi bëhet mbi bazën e pëlqimit, partia politike ka për detyrë të tregojë se qytetari ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave të tij personale.



3. PËRPUNIM MINIMAL

Partitë politike mund të mbledhin vetëm të dhëna personale të domosdoshme për qëllime zgjedhore, pa profilizim shtesë ose mbledhje të kategorive të veçanta të të dhënave personale (siç janë të dhënat mbi bindjet politike).

Bindjet politike përbëjnë kategori të veçanta të të dhënave personale dhe mund të përpunohen vetëm pas marrjes së një pëlqimi të qartë dhe të informuar nga qytetari ose në një formë tjetër të qartë ligjore sipas kushteve të parashikuara në nenin 13 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të dhënat personale të përfshira në Listën Zgjedhore nuk guxojnë të përdoren për asnjë qëllim tjetër, përveç për realizimin e të drejtës së votimit të qytetarëve.

Nëse përdoren teknika automatike ose digjitale për profilizim (p.sh. mikro-targetim), partitë politike janë të obliguara të vlerësojnë rrezikun, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e atyre teknikave, si dhe të kryejnë një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.



4. SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Partitë politike janë të obliguara të zbatojnë masa teknike dhe organizative për të siguruar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale për të gjitha kategoritë e subjekteve të të dhënave personale (punonjës, qytetarë, anëtarë, vullnetarë, vëzhgues, donatorë...) në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Partitë politike janë të obliguara të zbatojnë procedura për veprim në rast të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, që do të përfshijë edhe njoftimin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (jo më vonë se 72 orë pas dijensisë së cenimit) dhe qytetarëve të prekur.

Partitë politike kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale të përfshira në ekstraktin nga Lista Zgjedhore të dhënë në formë të shtypur ose elektronike nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, mbi kërkesën e tyre të mëparshme me shkrim.




5. TRANSPARENCA

Partitë politike kanë detyrimin që në mënyrë koncize, transparente, të kuptueshme dhe në formë lehtësisht të qasshme, duke përdorur gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, të informojnë qartë se si dhe pse përpunohen të dhënat personale të qytetarëve përmes njoftimeve publike ose politikave të privatësisë.



6. KUFIZIMI I AFATEVE TË RUAJTJES

Të dhënat personale nuk guxojnë të ruhen më gjatë sesa është e nevojshme për aktivitetet zgjedhore dhe partitë politike janë të obliguara t'i shkatërrojnë/fshijnë të dhënat personale pas përfundimit të procesit zgjedhor në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale




7. MARKETINGU DIREKT

Partitë politike mund të kryejnë marketing direkt (përmes postës elektronike, mesazheve SMS, telefonit, postës...) gjatë fushatës zgjedhore vetëm nëse kanë marrë pëlqimin e qartë paraprak nga qytetari sipas kushteve të parashikuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Partitë politike nuk guxojnë t'i përdorin të dhënat e mbledhura personale për marketing, qëllime komerciale ose për aktivitete jashtë fushatës zgjedhore.

Partitë politike kanë detyrimin të krijojnë kushte në mënyrë që qytetarët të mund ta realizojnë të drejtën e tyre për tërheqjen e pëlqimit në çdo kohë me mjete të thjeshta.



8. TRAJNIMI DHE PËRGJEGJËSIA

Të gjitha personat që marrin pjesë në fushatën zgjedhore (punonjës, vullnetarë, agjenci marketingu...) duhet të trajnohen për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të nënshkruajnë marrëveshje për konfidencialitet.



9. TË DREJTAT E QYTETARËVE

Partitë politike kanë detyrimin t'u mundësojnë qytetarëve:

- Të drejtën e qasjes, pra të mund të kërkojnë informacion për përpunimin e të dhënave të tyre personale,
- Të drejtën e korigjimit, fshirjes ose kufizimit të përpunimit nëse të dhënat janë të pasakta, nuk janë më të nevojshme ose përpunohen në mënyrë të paligjshme,
- Të drejtën e kundërshtimit ndaj përpunimit të të dhënave të tyre personale (në rast të profilizimit, marketingut direkt ose raste të tjera në kuadër të procesit zgjedhor).

Për këtë qëllim, partitë politike duhet të miratojnë dhe zbatojnë procedura për realizimin e të drejtave të qytetarëve në përputhje me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të zbatojnë masa për dorëzimin e kërkesave nga qytetarët në një formë lehtësisht të qasshme, të kuptueshme dhe transparente.



10. BASHKËPUNIMI ME ORGANIN MBIKËQYRËS

Partitë politike janë të obliguara të bashkëpunojnë me Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë përmbushjes së detyrave të saj, si dhe të caktojnë oficer/zyrtarë për mbrojtjen e të dhënave personale sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

➡ Shënim: Në procesin zgjedhor mund të marrin pjesë edhe koalicionet dhe grupet e zgjedhësve të cilët kanë të njëjtat përgjegjësi si partitë politike, pra edhe ata janë të obliguar t'i zbatojnë këto rekomandime në përputhje me rrethanat dhe gjendjet faktike që mund të shfaqen gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre zgjedhore, me qëllim të sigurimit të konsistencës gjatë zbatimit të dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë zgjedhjeve lokale